



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 353/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtri, paraqitur kundër Burim Jasharit – kryesues në V.V, në Vushtri për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik LDK dega në Vushtri.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.06.2014, nga subjekti politik LDK, dega në Vushtri, në të cilën pretendohet se gjatë plotësimit të FRK-së votat janë përshkruar gabimisht nga një numër më poshtë, për shembull: 31 ka kaluar në 30, votat e kandidatit nr. 40 kanë kaluar në 39 e tutje.

Prashtuesi i ankesës ka propozuar si dëshmitar Muhamet Demirin.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 353/2014 më datën 12.06.2014



Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.